



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	12/16
Nr. i fq. / Br. st	- 3 -
Data: / Datum	28. 01. 2016
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS -VUSHTRRI

**RREGULLORE (KKV) NR.01/2016 PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA  
DUKURITË QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE**

JANAR, 2016

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12.2 pika "c" dhe nenit 17 pika "s" të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 41.2. pika "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nr. 58/11 të dt. 28 Prill 2011, Kuvendi Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **28 janar 2016** miratoi:

**RREGULLOREN  
PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË  
DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim të mbrojë fëmijët nga të gjitha format dhe dukuritë që dëmtojnë shëndetin, sigurinë, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e tyre.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve. Kushtet në të cilat personat fizik, organizatat tregtare dhe shërbysese, mund t'u ofrojnë në shitje ose shërbime tjera që janë të ndaluara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, e që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve.

**Neni 3  
Përkufizimet**

- 3.1 Të mitur konsiderohen personat prej moshës 14 deri në 18 vjeç.
- 3.2 Të mitur të rinj janë personat prej moshës 14 deri 16 vjeç.
- 3.3 Të mitur të rritur janë personat prej moshës 16 deri 18 vjeç.
- 3.4 Dukuri negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve konsiderohen: konsumimi i alkoolit, duhanit, narkotikëve të ndryshëm, shfaqjet degeneruese, frekuentimi i të rinjve në lokalet e ndryshme në orët e vona etj.
- 3.5 Vende publike janë hapësirat, lokalet e ndryshme hoteliere shërbysese dhe tregtare, kafiteritë, internet kafet, institucionet kulturore, objektet edukativohësive, kinematë dhe lokalet e natyrës së tillë.

**Neni 4  
Veprimet e ndaluara të objekteve afariste ndaj të miturve**

- 4.1 Ndalohet rreptësishët shitja dhe përdorimi i të gjithave pijeve alkoolike dhe duhanit brenda objekteve edukativohësive.
- 4.2 Të gjitha subjektit nga neni 3 paragrafi 5 të kësaj rregullore, janë të obliguar që në hyrje apo në brendi të vendosin tabelën (shenjën) për ndalimin e shitjes dhe shërbimit të pijeve alkoolike dhe duhanit për të mitur, konform dispozitave të kësaj rregulloreje.
- 4.3 Ndalohet shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike për të miturit nga subjektit afariste.
- 4.4 Ndalohet shitja dhe shërbimi me duhan, apo çdo lloj tjetër i duhanit të miturve nga subjektit tregtare që merren me shitjen dhe shërbimin e tyre.

4.5 Ndalohet rreptësishtë që personat nën moshën 18 vjeçare të shesin pije alkoolike dhe duhan.

#### **Neni 5**

#### **Obligimet e subjekteve të bizneseve dhe të miturit**

- 5.1 Të miturit nën moshën 16 vjeçare, mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli vetëm në prani të prindit ose kujdestarit ligjor.
- 5.2 Të miturit e rritur mund të qëndrojnë deri në ora 20:00, ndërsa pas orës 20:00, vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
- 5.3 Ndalohet hyrja e të miturve në lokalet si: loto, bingo, prognoza sportive apo lojëra fati.
- 5.4 Organizatorët e shfaqjeve të ndryshme, programeve dhe manifestimeve publike dhe kulturore për të rinjtë në lokalet e mbyllura janë përgjegjës në rast se në ato lokale, lejohet përdorimi i pijeve alkoolike apo duhanit nga të miturit, në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

#### **Neni 6**

#### **Kinematë, Internet kafetë dhe Shtypi**

- 6.1 Kinematë apo subjektet tjera që merren me shfaqje publike të filmave, janë të detyruara që përfëmijët deri në moshën 14 vjeçare të shfaqin ato deri në ora 16:00, prej moshës 14 deri në 16 vjeçare deri në ora 18:00, ndërsa përtë miturit prej 16 deri në 18 vjeç deri në ora 20:00.
- 6.2 Pas orës 20:00 shfaqjet e tillë të miturit, mund t'i përcjellin vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
- 6.3 Kinematë, apo subjektet tjera janë të obliguara që me rastin e shfaqjes së filmave, përbajtja e të cilave ndikon negativisht në formimin e të miturve në aspektin edukativ, arsimor dhe kulturor, të njoftojnë me rastin e reklamimit të filmit si dhe në hyrje të objektit ta kenë shenjën për ndalimin e hyrjes, dhe njëkohësisht janë të obliguara që mos të lejojnë hyrjen e tyre në shfaqje.
- 6.4 Internet kafetë janë të obliguara që ta ndalojnë hapjen e faqeve të cilat ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit dhe edukimit të tyre.
- 6.5 Botuesit dhe shitësit e revistave të ndryshme, përbajtja e të cilave është degjeneruese dhe të cilat ndikojnë negativisht në edukimin arsimor, shëndetësor dhe kulturor të të miturve, nuk mund t'uua shesin të miturve deri në moshën 18 vjeçare.
- 6.6 Video klubet apo subjektet që merren me shijen e videokasetave, DVD-ve, CD-ve, përbajtja e të cilave është degjeneruese, janë të obliguara që të miturve të mos u shesin dhe të mos u lejojnë përdorimin e tyre.

#### **Neni 7**

#### **Zbatimi dhe mbikëqyrja**

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Inspektorët komunal dhe policia do të kujdesen dhe të mbikëqyrin zbatimin e kësaj rregullore nga subjektet përkatëse dhe do të ndërmarrin masat dhe veprimet përkatëse sanksionuese.

**Neni 8**  
**Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat**

1. Personi juridik-subjekti afarist, nëse në lokalin e tij shet ose shërben pije alkoolike në kundërshtim me dispozitat nga neni 4 paragrafi 1,3,4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje, për kundërvajtjen e kryer, do të dënohet me gjobë, njëjtë siç janë të përcaktuara në nenin 103 pika (l) të Ligjit nr. 2004/16 mbi veprimtarin hoteliere dhe turistike, ndërsa personi fizik që shkel dispozitat e nenit 4 paragrafi 1,3,4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, dënohet me gjobë mandatore prej (dy qind) 200.00€.
2. Me gjobë mandatore në shumë prej (pesëdhjetë) 50.00€ do të dënohen:
  - 2.1. Nëse të miturit i lejohet qëndrimi në restorant apo kafiteri etj, në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 paragrafit 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje;
  - 2.2. Nëse subjektet nga neni 5 paragrafi 3 veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje;
  - 2.3. Organizuesit e shfaqjeve, manifestimeve etj, veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 5 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
3. Me gjobë mandatore në shumë prej (pesëdhjetë) 50.00€ dënohen personat përgjegjës të subjekteve nga neni 5, nëse nuk respektohen dispozitat e paragrafit 2.1 të këtij neni dhe veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

**Neni 9**  
**Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

1. Nëse subjektet nuk bëjnë pagesën e gjobave të shqiptuara në pajtim me dispozitat e nenit 8 paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së shqiptimit të gjobës, do të inicohet procedura për ekzekutim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës Dega në Vushtrri

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

